

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 64, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.10-4095/1 datë 04.10.2024 dhe Konkluzionin nr.02-4644/11 datë 18.11.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare RADIODIFUZIVE (SHTR) KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 64, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 10 shtator 2024, në emisionin „Pastel“, deklaratat e bashkëfolësit është transmetuar burimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe dhe maqedonisht.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikura në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.10-4095/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e tij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. Urdhërohet SHTR KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veprimi sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij konsiderohet dita e certifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele sipas kërkesës, dhe të pakos programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, certifikatave të dhëna për regjistrim, akte nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akte nënligjore bazuar në Ligjin e njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64, paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të detyruar të transmetojnë programin në gjuhën maqedone dhe alfabetin kirilik, dhe në rastet kur programi është i destinuar për bashkësinë joshumicë, dhe në gjuhën e bashkësisë.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 3 tetor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 10 shtator 2024, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se në shërbimin programor të SHTR KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup, më 10 shtator 2024, në pjesën e fundit të emisionit „Пастел (Pastel)“, është realizuar reportazh me pjesë nga ekipi i punonjësve në fabrikë “Kromberg&Schuberg”, nga ku deklarata e bashkëfolësit është transmetuar burimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe ose maqedonisht.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.10-4095/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KOMPANI 21–M SHPKNJP Shkup më 07.10.2024, dërgoi Shkresë ark.nr.10-4125/2 datë 07.10.2024, me të cilën i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.10-4095/1 datë 04.10.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt më 07.10.2024, nga ku në afatin e parashikuar SHTR KOMPANI 21–M SHPKNJP Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR KOMPANI 21–M SHPKNJP Shkup t'i shqiptoi masë-paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, në lidhje me nenin 64, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikadhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) dhe Konkluzionin nr.02-4644/11 datë 18.11.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur 15.11.2024, miratoi Aktvendimin me të cilin publikisht paralajmëron SHTR KOMPANI 21–M SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veprimi sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa mësipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, nr.10-4095/1 datë 04.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.